



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 60/01-3900/23
Kaçanik, 21.02.2023

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **II (dytë)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VII e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 21 shkurt 2023. Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës komunale, në sallën e komiteteve, me fillim pune në ora 11:00.

Pjesëmarrës në mbledhje nga Komiteti për Politikë dhe Financa- KPF ishin 7 anëtarët: Kemal Murseli, Kadri Krivenjeva, Fitore Vishi, Kadrije Lika-Troni, Agim Mani, Ardita Rrahmani, Rabije Sallahi.

Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, drejtorët e drejtorive: Bahri Selimi-DBF, Dardana Tafili-Dauti-DAP, Hafize Sallahi - DKRS, Ramadush Osmani-DSHPE, Suhad Dullovi-DBZHRP, Sali Malsiu-DSHMS, ndërkaq nga zyrtarët ishin: Fatlume Guri-Selimi dhe Mavije Murseli.

Mbledhjen e monitoroj nga OSBE- Faruk Dërmaku.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Procesmbajtës: Makfire Malsiu- zyrtare për punë të KK.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, kushte pune me u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e II (dytë) të rregullt të KPF-a për vitin 2023, data 21 shkurt, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;
2. Raporti i Ekzekutivit të Komunës për vitin 2022;
3. Raporti Vjetor Financiar për periudhën, Janar-Dhjetor 2022;
4. Informatë për përfundimin e Gjysmë vjetorit të Parë të Vitit shkollor 2022/2023;
5. Informatë për menaxhimin e burimeve njerëzore për periudhën Janar-Dhjetor 2022;
6. Raporti i punës i Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2022;
7. Raporti vjetor lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e Auditimit të Brendshëm për vitin 2022;
8. Propozim Vendimi për subvencionim të fermerëve;
9. Propozim Vendim për subvencionim të OJQ-ve në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Lidhur me rendin e punës Kryesuesi i Kuvendit e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë Rendi e punës e shtroj në votim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF

Aprovoj

Rendi e punës në përbërje prej 9 pikëve.

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KPF u aprovua njëzëri, pa vërejtje. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së I (parë) të rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) për vitin 2023 të datës 24.01.2023 / Lënda: 01Nr. 60/03-1889/23.

2. Raporti i Ekzekutivit të Komunës për vitin 2022;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Raporti është bukur voluminoz, gjatë leximit kam vërejtur disa paqartësi, në disa nga drejtoritë: Të DAP, thuhet se lëndë të përfunduara janë 33015 lëndë, ndërkaq certifikata dhe ekstrakte të lindjes janë mbi 20 mijë. Desha me pyetur drejtoreshën: A janë në harmoni këto shifra me drejtorinë e financave ? Me intereson të di, cilat kategori lirohen nga certifikatat e lindjes dhe certifikatave tjera, sepse inkasimi është me i vogël në raport me lëshimin e certifikatave.

Kryesuesi i Kuvendit: Certifikatat munden me u shkarkua edhe prej e-Kioskave e-Kosova sistemit. Sa i përket kategorive që lirohen janë të përcaktuar në rregulloren e taksave komunale.

znj. Dardana Tafili-Dauti: Numri i lëndëve 33015 janë lëndë të krejt drejtorive. Unë kam raportuar edhe për qendrën për shërbim me qytetarë të krejt drejtorive. Kur flasim për certifikata, janë certifikata të cilat i lëshon gjendja civile. Çdo certifikatë regjistrohet pavarësisht llojit dhe hynë përmes intranetit dhe kryhet pagesa, por ka edhe certifikata për të cilat janë të liruar kategori të caktuara nga pagesa, e që kanë vërtetim-kartelën që është veteran i luftës, rast social dhe kategori tjera të cilat janë të liruar nga taksat komunale.

z. Agim Mani: Sa ka qenë numri i regjistrimeve të lindjeve në vitin 2022 ?

znj. Dardana Tafili-Dauti: Tani nuk e kam raportin këtu, janë të paraqitura në raport lindjet, vdekjet, vendimet për regjistrimet e mëvonshme të lindjeve dhe vdekjeve dhe çdo kategori tjetër që ka të bëjë me fushën e gjendjes civile. Regjistrimet e mëvonshme kanë edhe një taksë komunale tjetër si procese pak me të jashtëzakonshme.

z. Agim Mani: Të ndriçimi publik shihet se në vitin 2022 ka pasur diskriminim sa i përket buxhetit të shpenzuar në këtë fushë. Është një shumë 12,969€, 369 trupa. Fakti që themi se ka diskriminim, sepse 30% e shumës buxhetore kanë shkuar në Kaçanik të Vjetër, ku në këtë fshat ka përfunduar edhe faza e tretë, e që është diskriminim në raport me komunitetet tjera, përfshirë edhe fshatin nga vijë unë Stagovën, ku kanë ardhur vetëm 42 trupa.

Çështja e trajtimit të qenve endacak, thuhet janë trajtuar 185 qenë endacak në vitin 2022, pyetja është, ku janë vendosur këta qenë endacak pas trajtimit të tyre?

z. Ramadush Osmani: Të ndriçimi publik, prioritet janë rrugët të cilat kanë vijë gjatësore dhe rrugë me prioritet të fshatrave dhe lokaliteteve. Kaçaniku i Vjetër i ka dy rrugë kryesore: “Komandant Bardhi” dhe “Epopeja e UÇK” me atë gjatësi që e kanë. Në f. Stagovë është trajtuar rruga kryesore deri të shkolla, në bazë të gjatësisë së rrugës kanë dalë edhe trupat. E kemi edhe lagjen Dashi e cila është rrugë me prioritet. Trajtimi i qenve endacak është me tender, kryhet nga kompani të licencuara, e cila i merr qentë pa pronar, i dërgon në ordinancë i trajton për 3 -7 ditë, dhe me ligj i kthehen në vendin e origjinës. Kështu veprojnë krejt komuna. Vetëm një rast është vërtetuar se ka pasur sëmundje.

z. Agim Mani: Sipas raportit, në mirëmbajtje të rrugëve verore dhe rrugëve, është cekur operatori dhe punët të cilat i ka kryer, shuma është 200,000€. A është e vërtetë ?

z. Ramadush Osmani: Po, e vërtetë është.

znj. Ardita Rrahmani: Nuk e di a është pyetja e duhur me paraqit në këtë pikë, përderisa nuk kam marrë ende përgjigje të mbledhjes se kaluar lidhur me grantin e performancës. Cilat kanë qenë arsyet që komuna nuk e ka përfituar grantin e performancës ? Unë disa prej arsyeve i di, disa nuk i di.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Vlerësimi është paraqitur në raportin e auditorit.

Kryesuesi i Kuvendit: Kriter bazë është raporti i auditorit i pamodifikuar.

znj. Ardita Rrahmani: Të shërbimet mortore të cilat kryhen, është një shumë mbi 43 mijë euro që është paguar. Cilat shërbime i përfshinë kjo shumë, për arsye se po ka raste të vdekjeve, për të cilat familjet po detyrohen me paguar për shërbime të varrimit.

Kryetari i Komunës: Vetëm hapja e varrit nuk paguhet nga komuna, ndërkaq shërbimet tjera të gjitha i paguan komuna.

znj. Kadrije Lika-Troni: Të pastrimi dhe mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve, ka shumë mbeturina. A ka ujë të varrezat e dëshmorëve? Nëse nuk ka ujë aty, nuk ka mundësi ujitje për një ambient gjelbërues. A ka pasur mundësi me mbjellë drunjtë gjelbërues jo gjithënjë, si pisha etj. që me u krijuar një ambient me gjelbërues aty, se drunjtë ekzistues janë pa gjethë?

Kryesuesi i Kuvendit: Ujë ka të varrezat e dëshmorëve, por nuk e paskeni vërejtur znj. Kadrije. Diskutime tjera nuk ka, atëherë a jeni që kjo pikë t’i kaloj KK në procedurë për shqyrtim? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF

Njoftohet

Me Raportin e Ekzekutivit të Komunës për vitin 2022. Ky raport i përcjellë KK për shqyrtim.

3. Raporti Vjetor Financiar për periudhën, Janar-Dhjetor 2022;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Ky raport është i hartuar me ndryshe se herëve tjera, është pak me i vështirë me e kuptuar. Të te HVK të planifikimi, a mundet me ndryshuar në total planifikimi, se ndryshime keni bërë në planifikim për me iu dalë përqindja e realizimit?

z. Bahri Selimi: Raporti kështu ka shkuar edhe në ministri, janë përfshirë edhe do të dhëna, si e pasuria. Të te HVK planifikimi është 689,430€, nuk po e kuptoj se çka kemi ndërruar.

Kryesuesi i Kuvendit: Krahasset mundën me u bërë me buxhetin e votuar në shtator, a është planifikimi i saktë me buxhetin e miratuar? Ndërkaq gjatë periudhave 3,6 dhe 9 mujore mundën me pasur edhe lëvizje të mjeteve buxhetore.

z. Bahri Selimi: Nëse është ndryshuar diçka, atëherë kemi bërë gabim, por nuk ka mundësi. Të HVK direkte janë 689,430€.

z. Agim Mani: Shikoni të DSHPE në total sipas raportit janë 3,500€, kurse i kemi 13,500€, 10,000€ prej tyre janë të taksat dhe tatimet publike, 3,000€ janë të shfrytëzimi publik për tregjet e hapura që i bien 13,500€. Ka edhe dallime tjera të planifikimi i të HVK. Tjetër, nuk janë planifikuar të hyrat indirekte, ndërkaq ne duhet me ditur sesa mund të janë këto të hyra.

z. Bahri Selimi: Të HVK indirekte nuk planifikohen, ndërkaq të shërbimet publike dhe emergjente, e shikoj se si duket është bërë një gabim teknik.

Kryesuesi i Kuvendit: Të HVK indirekte janë të hyrat të cilat nuk mund të planifikohen. Ato të hyra realizohen nga gjobat në trafik. Të HVK që i realizojmë vet, mundem me bërë planifikim, ndërkaq për ato që nuk i realizojmë vet, nuk mundem me i planifikuar.

z. Bahri Selimi: Të HVK janë grumbulluar mbi 200,000€ këto të hyra mblidhen nga vendimet e gjykatave, gjobave në trafik dhe nga Agjencia e pyjeve i Kosovës. Mjetet iu alokohen komunave varësisht prej territorit, ne e kemi vetëm të drejtën e pranimi të tyre. Sa herë kemi bërë shpalosë të HVK, kemi bërë të te HVK direkte,

z. Agim Mani: Të shërbimet publike dhe emergjente, e pranove që është bërë gabim teknik, 6,999€ realizimi. Me intereson të di nga janë mbledhur këto mjete, sepse parkingu nuk ka funksionuar?

z. Bahri Selimi: Këto mjetet janë realizuar të parkingu publik.

z. Ramadush Osmani: Parkingu publik ka funksionuar

Kryetari i Komunës: Parkingu publik ka funksionuar 4-5 muaj, ndërkaq në kohën kur nuk ka funksionuar kompanisë iu është ndërpre kontrata.

z. Ramadush Osmani: Parkingu në bulevard, e kemi me marrëveshje me "Pastërtia", e cila ka funksionuar nga shtatori 2022. Të hyrat realizohen të banesa P+8, janë 22 parkingje që bëjnë pagesë vjetore. Kemi edhe parkingje të Stacioni i autobusëve, ka banor që paguajnë për 1 vit parkingun e rezervuar, pastaj parkingjet në rrugën: Sali Bajra dhe Qamil Ilazi. Me herët kemi pasur kontratën 1 vjeçare me të cilën kompania ka menaxhuar me parkingjet në bulevard, tani e ka kompania "Pastërtia" në kundërvlerë me mirëmbajtjen e hapësirave publike.

z. Agim Mani: Këto mjete d.m.th. nuk janë nga parkingjet publike që e ka marrë në këmbim kompania "Pastërtia" në kundërvlerë me mirëmbajtjen e hapësirave publike?

Kryesuesi i Kuvendit: Të shuma 3,500€, me mbledhë shumën del 13,000€, por është gabuar numri një (1) përpara.

z. Bahri Selimi: E korrigjoj gabimin dhe ua përcjelli të gjithë anëtarëve të KK.

z. Agim Mani: A ka mundësi me ditur drejtor: Sa mjete kanë ngelur në suficit buxhetor nga buxheti i vitit 2022 ? A keni arritur me i shfrytëzuar të HVK të vitit të kaluar, sepse sa e di unë ka bërë ndryshime diçka ministria në këtë drejtim?

z. Bahri Selimi: Sqaroj për mjetet që kanë ngelur në suficit buxhetor nga secili, të projektet na janë kthyer mjete 98,716€, 4.470 € të Mallrat dhe Shërbimet, Shpenzimet komunale, 4,867 €. Të HVK të vitit të kaluar nuk kemi arritur me i shpenzuar të gjitha. 814,000 € kanë ngelur nga vitet paraprake, të cilat mjetet do të barten në buxhetin e vitit 2023 në seancën e muajit mars. Të HVK ka pasur tendencë me iu kthyer qeverisë ato që ngelin në suficit, por falë LDK që e ka iniciuar këtë çështje në Kuvendin e Kosovës, është ndal kjo punë.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, a jeni që ky raport t'i shkoj KK në procedurë për shqyrtim ? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF

Njoftohet

Me Raportin Vjetor Financiar për periudhën, Janar-Dhjetor 2022. Ky Raport i përcjellët KK për shqyrtim.

4. Informatë për përfundimin e Gjysmë vjetorit të Parë të Vitit shkollor 2022/2023;

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtori nuk është këtu për shkak të një angazhimi tjetër, nëse ka kush diçka, është kryetari që mund të jap sqarime. E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Sa drejtorëve të shkollave iu ka skaduar mandati, ndërkaq punojnë si ushtrues detyre të drejtorit ? Sa konkurse janë shpallur për drejtor të shkollave?

Kryetari i Komunës: Janë 3 pozita të drejtorëve të shkollave që iu ka skaduar mandati, ndërkaq punojnë si u.d. të drejtorit. Sa i përket pyetjes tjetër, është çështje e Zyrës së personelit, konkuset janë publike.

Kryesuesi i Kuvendit: Lidhur me konkuset, të dhënat janë të raporti i zyrës së personelit. Diskutime tjera nuk ka, atëherë e jeni që kjo informatë t'i kaloj KK në procedurë shqyrtimi? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF

Njoftohet

Me Informatën për përfundimin e Gjysmë vjetorit të Parë të Vitit shkollor 2022/2023. Kjo informatë i përcjellët KK për shqyrtim.

5. Informatë për menaxhimin e burimeve njerëzore për periudhën Janar-Dhjetor 2022;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë a jeni që kjo informatë t'i kaloj KK ? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF

Njoftohet

Me Informatën për menaxhimin e burimeve njerëzore për periudhën Janar-Dhjetor 2022. Kjo informatë i përcjellët KK për shqyrtim.

6. Raporti i punës i Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2022;

Kryesuesi i Kuvendit: Ky raport është hartuar nga zyrtarja e KK, ku është bërë përmbledhja e aktiviteteve të KPF. E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë a jeni që ky raport t'i kaloj KK ? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF

Njoftohet

Me Raportin e punës i Komitetit për Politikë dhe Financa për vitin 2022. Raporti i përcjellët KK për shqyrtim dhe aprovim.

7. Raporti vjetor lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e Auditimit të Brendshëm për vitin 2022;

Kryesuesi i Kuvendit: Raporti i auditorit duhet me u miratuar nga kryetari, mirëpo po kërkohet me u diskutuar në KK për shkak të grantit të performancës. E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë a jeni që kjo informatë t'i kaloj KK ? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF

Njoftohet

Me Raportin vjetor lidhur me auditimet e brendshme të kryera dhe aktivitetet e Auditimit të Brendshëm për vitin 2022. Kjo raport i përcjellët KK për shqyrtim.

8. Propozim Vendimi për subvencionim të fermerëve;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: A ka mundësi drejtor me i bërë disa politika lokale, se shumica e fermerëve subvencionet po i shfrytëzojnë nga ministria, ndërkaq ata të cilët i kanë nën 5 lopë, nuk përfitojnë asgjë nga subvencionet. Ka qenë mirë edhe vaksinimi i lopëve me u bërë në nivel lokal dhe kjo kishte me iu ndihmuar bizneseve të vogla të cilët nuk përfitojnë subvencione nga ministria.

z. Suhad Dullovi: DBPZHR këtë vit e ka marrë një iniciativë të tillë që me i mbështetet fermerët të cilët i kanë me pak se 5 lopë. Do të ketë makina mbjellëse, ku do të informoheni se shpejti me vendimin të cilin e kemi si drejtori.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, atëherë a jeni që ky Propozim Vendimi t'i kaloj KK ? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në sajë të kësaj del konstatimi së KPF

Aprovoj

Propozim Vendimin për subvencionim të fermerëve. Ky propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

9. Propozim Vendim për subvencionim të OJQ-ve në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: E dimë se kjo shumë ka kaluar me miratimin e buxhetit, gati 70,000€. Pyetje për drejtoreshën: Sipas planit strategjik të juaj, cili është plani për OJQ ? Kur ne e kuptojmë se sa është subvencionuar secila nga OJQ veç e veç, kur të bëhet raporti financiar? A keni pasur paraprakisht takim me OJQ, a e keni marrë planin e tyre ? OJQ mund t'i bëjnë planet e tyre edhe mbi shumën

e përcaktuar si në propozim vendim. Ne e dimë në vitin e kaluar sesi janë ndarë subvencionet, andaj po iu bëjë pyetje.

znj. Hafize Sallahi: Sqaroj për procedurat, bëhet shpallja publike, është rregullorja që e rregullon ndarjen e subvencioneve.

Kryesuesi i Kuvendit: Bëhet thirrja publike dhe OJQ konkurrojnë me plan. Drejtoria ka me bërë përzgjedhjen e atyre projekteve dhe përsëri ka me sjellë në KK. OJQ nëse bëjnë plane me çmime qysh po thoni ju, nuk përfiton subvencione. OJQ kanë me konkurruar me plane në kuadër të buxhetit që është i ndarë për subvencioninimin e tyre.

znj. Hafize Sallahi: Vitin e kaluar e njëjta procedurë është zhvilluar. Kemi pasur takime me OJQ, kemi bërë shpalljen publike, është formuar komisioni. Komisioni ka bërë ndarjen për secilën OJQ veç e veç, është bërë publikimi i tyre, ka qenë i formuar edhe komisioni për monitorim se a janë realizuar projektet për të cilat janë ndarë subvencionet. Të shuma, 19,500€, janë për projekte të fushës së kulturës, ne këtu i kemi 3 SHKA, por kemi edhe grupe të rinjve siç është KVRL etj. Të fusha e sportit, i kemi 14 klube sportive, edhe 3 të reja janë regjistruar sivjet, të cilat besoj se aplikojnë sivjet për subvencione. Ne mbajmë edhe debat publik për ndarjen e subvencioneve, nuk e di çka me tepër po të intereson.

z. Agim Mani: Mua me intereson me saktë me në detaje sesi ka me u bërë ndarja e subvencioneve.

znj. Hafize Sallahi: Unë nuk bëjë ndarje të subvencioneve, ndarjen e bënë komisioni.

z. Agim Mani: Duhet me pasur planin e OJQ për ndarje të subvencioneve, se plani është baza për ndarjen e subvencioneve.

Kryesuesi i Kuvendit: Nuk mundet drejtoria me bërë plane për klube apo OJQ, se nuk e dinë kush aplikon. Klubet dhe OJQ i bëjnë vet planet dhe konkurrojnë me planet e tyre.

Kryetari i Komunës: Nuk mundesh me bërë plan, se nuk e dinë cilat nga klubet sportive apo OJQ do të aplikojnë për subvencione.

znj. Hafize Sallahi: A e ke parë planin e DKRS, aty janë të shënuar aktivitete, ku këto OJQ dhe klubet sportive në këtë thirrje konkurrojnë për me mbështetur planin e punës së drejtorisë.

znj. Ardita Rrahmani: Kam një pyetje: A lejohet subvencionimi edhe për individ, se këtu po shkruan për OJQ ? Këtë pyetje po e bëjë, për arsye sa ka individ që ushtrojnë veprimtari të ndryshme të cilat nuk subvencionohen.

Kryesuesi i Kuvendit: Subvencionimi i individëve për veprimtari të caktuara, shkojnë përmes vendimeve të kryetarit të komunës.

znj. Hafize Sallahi: Në Rregulloren e ministrisë së financave 04/2017 janë të specifikuara subvencionimi i krejt OJQ që janë të regjistruara dhe kanë vërtetim nga ministria, ndërkaq për individ nuk kam pasur ndonjë rast.

znj. Ardita Rrahmani: Individët ku duhet me aplikuar me përfutur nga subvencionet, se deri tani e di se nuk ka pasur ndonjë aplikim, se nuk ka pasur bazë për subvencionimin e veprimtarive të tyre.

znj. Kadrije Lika-Troni: Ka individ që ushtrojnë veprimtari të caktuara, si botimi i ndonjë libri apo të ngjashme, të cilët në mungesë të subvencionimit të veprimtarisë së tyre, mund të mos kenë mundësi me realizuar veprimtarinë e tyre.

Kryesuesi i Kuvendit: Për individ duhet aplikuar të zyra e kryetarit, nën shumën 1,000€, mbi këtë shumë është sjellë propozimi në KK. Drejtoria e ka bërë planin e saj për kategori të caktuara dhe ato kategori kanë me konkurruar me plane. Nuk mundet drejtoria me futur në propozim vendim subvencionimin e një turneu të shahut, kur ne nuk e dimë a ka me organizuar turneu i shahut dikush apo jo, sepse së pari merret oferta, pastaj veprimet tjera.

znj. Ardita Rrahmani: Arsye pse e ngrita këtë çështje është se, ka individ të caktuar që merren me veprimtari të caktuara, mirëpo në mungesë të mjeteve nuk mundet me realizuar një projekt për shkak të kostos financiare.

Kryetari i Komunës: Fillimisht janë subvencionuar kategori të caktuara për veprimtari individuale, mirëpo filloj numri të bëhet aq i madh, saqë nuk patëm mundësi. Megjithatë ne prapë jemi për me i subvencionuar, varësisht kur e vlerësojmë se është e domosdoshme një subvencionim i tillë, do të veprojmë.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni që ky propozim vendim t'i shkoj KK? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF e,

Aprovoj

Propozim Vendim për subvencionim të OJQ-ve në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Ky propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

Diçka tjetër për këtë takim nuk ka, kështu e konstatoj mbledhjen e përfunduar në ora: 11:47. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët e KPF.

Mbledhja e Kuvendit do të mbahet me 27 shkurt 2023 në ora 11:00.

Procesmbajtës
Makfite Malsiu

Makfite Malsiu

